

INFINITY

Udhëzimet e Përdorimit

AL



PJANURË GATIMI PREJ XHAMI QERAMIKE E INKASUAR

I nderuar klient!



Pjanura e inkasuar prej xhami qeramike synohet për përdorim shtëpiak.

Produktet tona janë të ambalazuara në materiale miqësore me mjedisin të cilat mund të riciklohen, të hidhen ose të shkatërrohen pa u bërë barrë për mjedisin.

Udhëzime për përdorimin

Udhëzimet e përdorimit janë të synuara për përdoruesin. Ato përshkruajnë pajisjen elektroshtëpiake dhe operimin e saj. Udhëzimet zbatohen për lloje të ndryshme pajisjesh elektroshtëpiake dhe rrjedhimisht mund të përfshijnë funksione të cilat mund të mos jenë të disponueshme në pajisjen tuaj elektroshtëpiake.

Udhëzime për lidhjen

Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet në përputhje me udhëzimet e bashkëlidhura me të, si dhe në përputhje me rregullat dhe standardet përkatëse. Lidhja duhet të kryhet vetëm nga një person i kualifikuar.

Paneli i të dhënave

Paneli i të dhënave që tregon informacionin bazë për pajisjen elektroshtëpiake, është i ngjitur në pjesën e poshtme të pjanurës.

Mbrojtja kundër zjarrit

Kur pjanura e gatimit është e inkasuar, njëri element i mobiljes së kuzhinës i cili është më i lartë se pjanura mund të qëndrojë pranë saj në njërën anë, me kusht që elementi i kuzhinës në anën tjetër të pjanurës të mos jetë më i lartë se niveli i pjanurës.

TABELA

TË RËNDËSISHME - LEXOJINI PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES	
ELEKTROSHTËPIAKE	5
Paralajmërimi për sigurinë.....	5
Paralajmërimi	6
PËRSHKRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE	7
ZONAT E GATIMIT	8
Përpara përdorimit të pajisjes elektroshtëpiake për herë të parë.....	8
Paralajmërimi të rëndësishme.....	8
Enët e gatimit.....	9
Kursimi i energjisë.....	10
OPERIMI I PJANURËS SË GATIMIT - ZONAT TRADICIONALE.....	11
Çelësi i zonës dyshe të gatimit.....	12
Dritat e kontrollit	12
PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA.....	13
Pastrimi	13
INSTALIMI	15
Paralajmërimi të rëndësishme.....	15
Instalimi i guarnicionit prej sfungjeri.....	16
Përmasat e prerjes së bangos.....	16
LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE ME RRJETIN ELEKTRIK	18
Paralajmërimi të rëndësishme.....	18
Diagrama e lidhjes	19
KARAKTERISTIKAT TEKNIKE	20
Paneli i të dhënave.....	20

TË RËNDËSISHME – LEXOJINI PËRPARA PËR-DORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

Paralajmërime për sigurinë

- Kjo pajisje elektroshtëpiake mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjet e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndjeshmërie ose mendore apo mungesë eksperience dhe njohurie në qoftë se atyre ju është dhënë mbikëqyrje ose udhëzim në lidhje me përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake në mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet e mundshme. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake. Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdorimit nuk duhet të bëhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.
- KUJDES: Pajisja elektroshtëpiake dhe pjesët e saj të prekshme nxehen gjatë përdorimit. Duhet të kihet kujdes për të shmangur prekjen e elementeve të nxehtë. Fëmijët më pak se mosha 8 vjet duhet të mbahen larg nëse nuk janë të mbikëqyruar në mënyrë të vazhdueshme.
- KUJDES: Rrezik zjarri: mos mbani sende mbi sipërfaqet e gatimit.
- KUJDES: Gatimi i pambikëqyruar me vaj ose dhjamë në një pjanurë mund të jetë i rrezikshëm dhe mund të përfundojë në zjarr. Asnjëherë mos u përpiqni të shuani zjarrin me ujë, por fikeni pajisjen elektroshtëpiake dhe pastaj mbulojeni flakën me kapak ose me një leckë të lagur.
- Pas përdorimit, fikeni elementin e pjanurës nga kontrolli i saj dhe mos u mbështesni në detektorin e tiganit.
- KUJDES: Në qoftë se sipërfaqja është e krisur, fikeni pajisjen elektroshtëpiake për të shmangur mundësinë e goditjes elektrike.
- Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pllakën e gatimit, pasi kjo mund të rezultojë në goditje elektrike.
- Pajisja elektroshtëpiake nuk është synuar që të kontrollohet nga kohëmatësa të jashtëm apo sisteme të veçanta kontrolli.

Paralajmërimi


- Pajisja elektroshtëpiake mund të lidhet me rrjetin elektrik vetëm nga një teknik apo ekspert shërbimi i autorizuar.
- Ndërhyrja në pajisjen elektroshtëpiake ose riparimi joprofesionist i saj mund të rezultojnë në rrezik të plagosjeve të rënda ose në dëmtim të produktit. Të gjitha riparimet mund të kryhen vetëm nga një teknik apo ekspert shërbimi i autorizuar.
- Pajisja elektroshtëpiake është vetëm për qëllime gatimi. Mos e përdorni për asnjë qëllim tjetër, si p.sh. për ngrohje të dhomës. Mos vendosni enë gatimi bosh në zonat e gatimit.
- Në qoftë se në prizën elektrike të ndodhur në afërsi të pajisjes elektroshtëpiake, është lidhur një pajisje tjetër elektroshtëpiake, sigurohuni që kabllit elektrik të mos bjerë në kontakt me zonat e nxehta të gatimit.
- Mos mbani sende të ndjeshme ndaj temperaturës poshtë pajisjes elektroshtëpiake, si pastruesat apo detergjentë, kanaçe sprej, etj.
- Përdorimi i pjanurës prej xhami qeramike si zonë mbajtëse mund të rezultojë në gërvishetje ose në dëmtime të tjera të saj. Mos nxehtëni asnjëherë ushqim në fletë alumini ose në enë plastike mbi pjanurën e gatimit. Këto fletë ose enë mund të shkrijnë, gjë e cila mund të rezultojë në zjarr ose në dëmtim të pjanurës së gatimit.



Simboli në produkt ose në ambalazhin e tij tregon që produkti nuk duhet të trajtohet si mbeturinë e zakonshme shtëpiake. Në vend që të trajtohet kështu, ai duhet të merret nga një pikë zbatuese e grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Duke siguruar që ky produkt është hedhur siç duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme, negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, të cilat mund të shkaktohen në të kundërt nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjes së këtij produkti. Për informacion më të detajuar në lidhje me riciklimin e këtij produkti, ju lutemi të kontaktoni me zyrën e qytetit tuaj, shërbimin për hedhjen e mbetjeve shtëpiake ose me dyqanin ku e keni blerë produktin.

PËRSHKRIMI I PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE



1 2 3 4 5 6

1. Zona e gatimit mbrapa majtas
2. Zona e gatimit përpara majtas
3. Dritat sinjalizuese
4. Zona e gatimit mbrapa djathtas
5. Zona e gatimit përpara djathtas
6. Njësia e kontrollit të pianurës së gatimit

Përpara përdorimit të pajisjes elektroshtëpiake për herë të parë

Paralajmërime të rëndësishme

Pastrojeni sipërfaqen e xhamit prej qeramike pastrojeni me një leckë të lagur dhe me ndonjë detergjent për larjen e pjatave me dorë. Mos përdorni pastruesë gërryes, si pastruesë agresivë, si pastruesë gërryes të cilët mund të gërvishin sipërfaqen, sfungjerë gërryes për larjen e enëve ose heqës njollash.

- Mos e ndizni një zonë gatimi pa një tigan sipër saj dhe mos e përdorni asnjëherë pjanurën e gatimit për ngrohje dhomë!
- Sigurohuni që zona e gatimit dhe fundi i tiganit janë të pastër dhe të thatë dhe që midis tyre do të mundësohet transmetimi i një nxehtësie të mjaftueshme në mënyrë që të parandalohet çfarëdolloj dëmtimi i sipërfaqes nxehtëse.
- Të gjitha dhjamrat dhe vajrat e lëna në zonat e gatimit mund të ndizen. Prandaj, tregohuni të kujdesshëm kur të përdorni dhjamë dhe vaj për të përgatitur ushqimin (p.sh. patate të skuqura) dhe kontrollojeni procesin e gatimit gjatë gjithë kohës.
- Mos vendosni tiganë të lagur ose kapakë të mbuluar me avull në zonat e gatimit, pasi lagështira mund t'i dëmtojë ato.
- Mos e lini tiganin e nxehtë që të ftohet në zonat e gatimit që nuk janë në përdorim, sepse lagështira që mund të krijohet poshtë tij mund të shkakton gërryerje.


Këshilla të rëndësishme në lidhje me pjanurën prej xhami qeramike

- Zona e gatimit e arrin shumë shpejt nivelin e zgjedhur të fuqisë ose temperaturën; megjithatë, zona përqark zonave të gatimit mbetet relativisht e ftohtë.
- Pjanura është rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës.
- Pjanura është edhe rezistente ndaj goditjeve. Tiganët mund të vendosen pa kujdes në pjanurë pa e dëmtuar atë.
- Pjanurat prej xhami qeramike nuk duhet të përdoren si bango pune. Objektet e mprehta mund të shkaktojnë gërvishitje.
- Përgatitja e ushqimit në fletë alumini ose në enë plastike mbi zonat e nxehta të gatimit nuk lejohet. Mos vendosni asnjë objekt plastik ose fletë alumini në pjanurën e xhamit prej qeramike.
- Mos e përdorni asnjëherë një pjanurë prej xhami qeramike e cila është e krisur ose e thyer. Në qoftë se bie një objekt mbi pjanurë me cepin e mprehtë nga poshtë, kjo mund të shkaktojë që pjanura / paneli prej xhami qeramike të thyhet. Pasojat janë të dukshme menjëherë ose vetëm pas pak kohe. Në qoftë se do të shfaqet ndonjë krisje e

dukshme, shkëputeni menjëherë pajisjen elektroshtëpiake nga furnizimi me energji.

- Në qoftë se në një pjanurë të nxehtë prej xhami qeramike derdhet sheqer ose ushqim i lyer me sheqer, fshijeni menjëherë pjanurën.

Enët e gatimit




Këshilla për përdorimin e enëve të gatimit

Përdorni enë gatimi të cilësisë së lartë me fund të rrafshët dhe të qëndrueshëm.

- Transmetimi i nxehtësisë është më i mirë kur fundi i tiganit dhe zona e gatimit janë të të njëjtit diametër dhe tiganit është i vendosur në mes të zonës së gatimit.
- Kur përdorni xham të temperuar (Pyrex) ose enë gatimi prej porcelani, ju lutemi të zbatoni udhëzimet e prodhuesit të enëve të gatimit.
- Kur përdorni tenxhere me presion, mos e lini të pambikëqyrur derisa të arrihet presioni i dëshiruar. Zona e gatimit fillimisht duhet të vendoset në nivelin maksimal të fuqisë, pasi të rritet presioni, përdorini sensorët për të ulur nivelin e fuqisë në përputhje me udhëzimet e prodhuesit të tenxheres me presion.
- Sigurohuni që gjithmonë ka mjaftueshëm ujë, qoftë në tenxheren me presion ose enë tjetër të gatimit, pasi përdorimi i një tigan bosh në pjanurën e gatimit mund të rezultojë në mbinxehje, e cila do të dëmtojë edhe tiganin edhe zonën e gatimit.
- Enët e gatimit prej xhami të temperuar (Pyrex) me fund special të lëmuar janë të përshtatshme për t'u përdorur në pjanurat e gatimit në qoftë se përputhen me diametrin e zonës së gatimit. Enët e gatimit me diametër më të madh mund të thyhen për shkak të ngarkesës termale.
- Kur të përdorni çfarëdolloj enësh gatimi speciale ose jotradicionale, zbatoni udhëzimet e prodhuesit të enës së gatimit.
- Kur në një pjanurë prej xhami qeramike përdoret për gatim një tigan me pasqyrim të lartë (me sipërfaqe metalike të ndritshme) ose një tigan me fund të trashë, koha e gatimit mund të zgjatet me disa minuta (deri në 10 minuta). Në qoftë se dëshironi të zjeni një sasi më të madhe, rekomandohet që të përdorni një enë me fund të rrafshët të errët.
- Mos përdorni enë gatimi prej balte, pasi ato mund të lenë gërvishje në pjanurën prej xhami qeramike.

- Diametrat e fundeve të tiganëve duhet të përputhen me diametrin e zonës së gatimit. Në qoftë se tigani është shumë i vogël, do të shpërdorohet nxehtësia, përveç kësaj, duke përdorur një tigan shumë të vogël mund të dëmtohet zona e gatimit.
- Kurdoherë që të jetë e mundur në lidhje me procesin e gatimit, përdorni kapak.
- Tigani duhet të jetë me madhësi të përshtatshme në lidhje me ushqimin që do të përgatitet. Përgatitja e një sasive të vogël ushqimi në një tigan të madh do të shkaktojë shpërdorim të energjisë.
- Gatimet të cilat kërkojnë shumë kohë për t'u gatuar duhet të përgatiten në tenxhere me presion.
- Perimet e ndryshme, patatet, etj., mund të gatohen në sasi të vogla uji, megjithatë, kapaku duhet të mbyllet mirë. Kur uji fillon të ziejë, uleni nivelin e fuqisë në një parametër i cili e mban temperaturën fiks mbi temperaturën e zjerjes.


OPERIMI I PJANURËS SË GATIMIT - ZONAT TRADICIONALE



- Ndizeni zonën e gatimit duke përdorur çelësat e instaluar në panelin e kontrollit.
- Simboli pranë çdo çelësi tregon se cila zonë gatimi operohet prej tij.
- Niveli i fuqisë të zonës së gatimit mund të vendoset në mënyrë të vazhdueshme (1-9).
- Zona e gatimit mund të fiket tre deri në pesë minuta përpara përfundimit të gatimit, në mënyrë që të përdoret nxehësia e mbetur dhe të kursehet pak energji (tabela e mëposhtme liston disa shembuj për përdorimin e niveleve individuale të fuqisë).

E	
0	Fikja e zonës së gatimit
1-2	Ruajtja e temperaturës dhe rinxehja e sasive më të vogla të ushqimit
3-4	Rinxehja
5-6	Rinxehja ose gatimi më i gjatë i sasive më të mëdha
7	Gatimi / fërgimi i vazhdueshëm (p.sh. omëleta etj.)
8	Fërgimi i fortë
9	Nxehja e shpejtë

Çelësi i zonës dyshe të gatimit



Dritat e kontrollit



Kur çelësi i kontrollit të zonës së gatimit me dy unaza rrotullohet normalisht, aktivizohet zona bazë e gatimit (e brendshme). Në qoftë se dëshironi të aktivizoni të gjithë zonën e gatimit, rrotullojeni çelësin deri në simbolin i cili vazhdon pas shenjave të numrave, derisa të dëgjohet zhurma “klik”, pastaj rrotullojeni përsëri deri në pozicionin e dëshiruar. E gjithë zona e gatimit fiket duke e rrotulluar çelësin përsëri deri në pozicionin “0”.

Pjanurat e gatimit prej xhami qeramike janë të pajisura me drita paralajmëruese kontrolli në pjesën ballore të panelit. Në qoftë se ndizet një dritë e veçantë paralajmëruese e kontrollit, do të thotë që zona e gatimit korresponduese është e nxehtë (rrezik për djegie). Kur një zonë gatimi fiket, drita paralajmëruese mbetet e ndezur derisa zona e gatimit të ftohet nën 50°C.

PASTRIMI DHE MIRËBAJTJA

Pastrimi




Figura 1





Figura 2



Figura 3



Figura 4



Pas çdo përdorimi të pjanurës prej xhami qeramike, prisni që ajo të ftohet dhe pastrojini; në të kundërt, edhe mbetjet më të vogla të ushqimit do të digjen mbi sipërfaqen e nxehtë të pjanurës herën tjetër që do të përdorni pajisjen elektroshtëpiake. Për pastrimin dhe për mirëmbajtjen e zakonshme të sipërfaqes prej xhami qeramike, përdorni agjentë kondicionues të veçantë të cilët krijojnë një shtresë mbrojtëse mbi sipërfaqe, duke e mbrojtur nga papastërtitë. Përpara çdo përdorimi, fshini të gjithë pluhurat dhe grimcat e tjera nga sipërfaqja e pjanurës dhe nga fundi i tiganëve pasi ato mund të gërvishtin sipërfaqen (Figura 1).

Kujdes: lesi prej çeliku, sfungjerët gërryes dhe detergjentët gërryes mund të gërvishtin sipërfaqen e pjanurës. Sipërfaqja e xhamit prej qeramike mund të dëmtohet gjithashtu edhe nga spreit agresivë dhe agjentët e lëngshëm të pastrimit të tundur (përzier) në mënyrë të papërshtatshme ose të pamjaftueshme (Figura 1 dhe Figura 2).

Vijëzimet mund të fshihen gjatë përdorimit të pastruesave agresivë ose gërryes ose enëve të gatimit me fund të dëmtuar (Figura 2).

Njollat e lehta mund t'i hiqni me një leckë të butë të lagur, pastaj, fshijeni sipërfaqen për ta tharrë (Figura 3).

Njollat e ujit mund t'i hiqni duke përdorur një tretësirë të lehtë me uthull vere, megjithatë mos e përdorni këtë tretësirë për të pastruar kornizën (vetëm në disa modele), pasi ato mund të bëhen të padukshme. Mos përdorni spreit agresivë ose agjentë dekalçifikimi (Figura 3).

Njollat më të forta mund t'i hiqni duke përdorur agjentë specialë dhe mjete për pastrimin e pjanurave prej xhami qeramike. Kur t'i përdorni këto produkte, zbatoni udhëzimet e dhëna nga prodhuesit e tyre përkatës.

Sigurohuni që të gjitha mbetjet e agjentëve të pastrimit të hiqen plotësisht, pasi ato mund të dëmtojnë pjanurën prej xhami qeramike kur të nxehen zonat e gatimit (Figura 3). Hiqini njollat e forta dhe mbetjet e djegura me një kruajtëse (Figura 4).

Kur të përdorni kruajtësen, tregohuni të kujdesshëm për të parandaluar dëmtimet.



Kruajtësen përdoreni vetëm në rastet kur papastërtitë nuk mund të hiqen me një leckë të lagur ose me agjentë specialë pastrues për sipërfaqet prej xhami qeramike.

Mbajeni kruajtësen në këndin e duhur (45° deri në 60°).

Shtyjeni me ngadalë kruajtësen në drejtim të xhamit dhe rreshqiteni në drejtim të vijëzimit për të hequr papastërtitë.

Sigurohuni që doreza plastike e kruajtëses (në disa modele) të mos bjerë në kontakt me ndonjë zonë të nxehtë gatimit.



Mos e shtyni kruajtësen në drejtim pingul drejt xhamit dhe mos e gërvishni sipërfaqen e pjanurës me majën ose tehun e saj.



Figura 5

Ushqimet prej sheqeri dhe të veshura me sheqer mund të dëmtojnë përgjithmonë sipërfaqen prej xhami qeramike (Figura 5); rrjedhimisht, ato duhet të hiqen nga sipërfaqja prej xhami qeramike sa më shpejt që të jetë e mundur, megjithëse zona e gatimit mund të jetë ende e nxehtë (Figura 4).

Pastrojeni pjanurën prej xhami qeramike me një pastrues të butë jo gërryes dhe me një sfungjer të butë i cili nuk mund ta gërvishë sipërfaqen.

Çfarëdo ndryshim në ngjyrën e sipërfaqes prej xhami qeramike nuk e cënon operimin e saj ose qëndrueshmërinë e sipërfaqes. Këto ndryshime janë kryesisht si rezultat i mbetjeve të ushqimit të djegur ose i përdorimit të enëve të gatimit të prodhuara prej materialesh si alumini ose bakri; këto njolla është e vështirë të hiqet.

Kujdes: Të gjitha dëmtimet e përshkruara më poshtë kryesisht kanë të bëjnë me estetikën, d.m.th. me paraqitjen e pajisjes elektroshtëpiake dhe nuk e cënojnë drejtpërdrejt funksionalitetin e saj. Këto defekte nuk mund të jenë subjekt i pretendimeve për garanci.

Paralajmërimi të rëndësishme

- Instalimi i pajisjes elektroshtëpiake në bangon e kuzhinës dhe lidhja e saj me rrjetin elektrik mund të kryhet vetëm nga një teknik i kualifikuar në mënyrën e duhur.
- Rimesoja ose sipërfaqja tjetër e pjesës së mobiljes të kuzhinës në të cilën do të inkasohet pjanura duhet të trajtohet me ngjitës rezistent ndaj nxehtësisë (100°C); në të kundërt, sipërfaqja e bangos mund të çngjyroset ose të deformohet.
- Pjanura e gatimit është me përmasa që të inkasohet në bango mbi një pjesë të dollapit të kuzhinës, me gjerësi prej 600 mm ose më shumë.
- Pas instalimit, dy elementet shtrëngues ballorë duket të jenë të kapshëm lirisht nga poshtë.
- Elementet e varur ose të montuar në murin e kuzhinës duhet të instalohen në lartësi të mjaftueshme për të mos ndikuar në procesin e punës.
- Distanca midis pjanurës dhe aspiratorit të kuzhinës nuk duhet të jetë më pak nga sa është treguar në udhëzimet për instalimin e aspiratorit të kuzhinës. Distanca minimale është 650 mm.
- Distanca midis cepit të pajisjes elektroshtëpiake dhe elementit më të afërt vertikal të mobiljes së kuzhinës duhet të jetë jo më pak se 40 mm.
- Përdorimi i pllakave ose bordurave të mëdha dekorative prej druri në bangon prapa pjanurës së gatimit lejohet në qoftë se distanca minimale mbetet e njëjtë siç tregohet në vizatimet e instalimit.
- Distanca minimale midis pjanurës së gatimit të inkasuar dhe murit të pasëm tregohet në vizatimet e instalimit.

Instalimi i guarnicionit prej sfungjeri



Përpara se pajisja elektroshtëpiake të futet në hapësirën e bangos së kuzhinës, guarnicioni i dhënë prej sfungjeri duhet të ngjitet në pjesën e poshtme të pjanurës së xhamit prej qeramike (xhamit) (shikoni figurën më poshtë). **Mos e instaloni pajisjen elektroshtëpiake pa guarnicionin prej sfungjeri!**

Guarnicioni duhet të ngjitet në pajisjen elektroshtëpiake në formën e mëposhtme:

- Hiqeni filmin mbrojtës nga guarnicioni.
- Pastaj, ngjiteni guarnicionin në pjesën e poshtme të xhamit, afërsisht 2-3 milimetra nga cepat (siç tregohet në figurë). Guarnicioni duhet të ngjitet përgjatë gjithë gjatësisë së cepit të xhamit dhe nuk duhet të mbivendoset nëpër qoshe.
- Kur të instaloni guarnicionin, sigurohuni që xhami të mos bjerë në kontakt me asnjë objekt të mprehtë.


SHËNIM!

Në disa pajisje elektroshtëpiake, guarnicioni është i instaluar paraprakisht!



- Pjanura e gatimit mund të instalohet në bango të cilat janë me trashësi 30 deri në 50 mm.

- Elementi i mobiljes së kuzhinës nga poshtë pjanurës nuk duhet të jetë i pajisur me sirtar. Në qoftë se elementi i mobiljes së kuzhinës është një pjesë muri horizontal ai duhet të instalohet jo më pak se 60 milimetra nga sipërfaqja e poshtme e bangos. Hapësira midis pjesës së murit dhe pjanurës duhet të jetë bosh; në atë hapësirë nuk duhet të vendoset asnjë objekt.
- Në murin e pasëm të mobiljes duhet të jetë një prerje me gjerësi prej të paktën 175 mm gjatë gjithë gjerësisë së elementit të mobiljes.
- Vetëm llojet EVP4, EVP2..., të furrave të pajisura me ventilator ftohës mund të instalohen poshtë kësaj pjanure gatimi.



Procedura e instalimit

- Bangoja duhet të instalohet plotësisht horizontalisht.
- Sipërfaqet e prera duhet të mbrohen në mënyrën e duhur.
- Ngjitini elementet shtrëngues (4x - SVK6...600 mm; 6x - SVK7...750 mm; 6x - SVK8...850 mm) me vidhat e furnizuara (4x - SVK6...600 mm; 6x - SVK7...750 mm; 6x - SVK8...850 mm) në murin e përparmë dhe të pasëm të pjanurës së gatimit dhe të pjesës së hequr të bangos.
- Lidhni pjanurën e gatimit me rrjetin elektrik (shikoni udhëzimet për lidhjen e pjanurës së gatimit në rrjetin elektrik dhe në furnizimin me ga).
- Futeni pjanurën e gatimit në pjesën e prerë dhe ngjesheni fort nga sipër drejt bangos së punës.
- Për vidhosjen e poshtme të kapëses fiksuese, nuk lejohet përdorimi i vidhave më të gjata se 6,5 mm.
- Përpara instalimit të furrës, në zonën e prerjes së pjanurës së gatimit duhet të hiqet muri i pasëm i elementit të mobiljes së kuzhinës.

LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE ME RRJETIN ELEKTRIK


Paralajmërimet të rëndësishme

- Pajisja elektroshtëpiake mund të lidhet vetëm nga një ekspert i aftë i autorizuar.
- Sistemi i mbrojtjes elektrike duhet të përputhet me të gjitha rregulloret përkatëse.
- Kapëset lidhëse mund të arrihen kur të hapen/hiqen kapakët e kapëseve lidhëse.
- Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake, sigurohuni që tensioni i treguar në pllakën e të dhënave të jetë në përputhje me tensionin në qarkun e shtëpisë suaj.
- Pllaka e të dhënave me informacionin bazë është e ngjitur në pjesën e poshtme të pjanurës.
- Qarku elektrik duhet të përfshijë gjithashtu një çelës omipolar i cili do të ndajë pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik, në qoftë se nevojitet, me të paktën 3 mm distancë midis kontakteve. Pajisjet e përshtatshme përfshijnë siguresat, çelsësa për mbrojtjen nga rryma, etj.
- Lidhja duhet të zgjidhet në përputhje me mundësitë e instalimit, në lidhje me rrymën dhe siguresat.
- Duke pasur parasysh mbrojtjen nga rreziku i zjarrit, pajisjet elektroshtëpiake të këtij lloji mund të instalohen në një bango pas një pjese të mobiljeve të kuzhines e cila është më e gjatë se pajisja elektroshtëpiake (kur instalohet); megjithatë, në këtë rast, në anën tjetër në afërsi të pajisjes, duhet të vendoset një element i mobiljes së kuzhinës, jo më i lartë se pjanura e gatimit.
- Rryma që përcillet dhe pjesët e izoluar duhet të mbrohen nga çdo mundësi e kontaktit të drejtpërdrejtë.

KUJDES!

- Përpara çdo ndërhyrjeje në pajisjen elektroshtëpiake (të ndryshme nga përdorimi i zakonshëm), shkëputeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik. Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet në përputhje me skemën përkatëse (diagramën), subjekt i rrjetit elektrik. Lidheni telin e tokëzimit (PE) me kapësen e treguar me simbolin e tokëzimit.
- Kabllit i rrjetit duhet të ushqehet nëpërmjet pajisjes kapëse liruese/shtrënguese e cila e mbron nga tërheqja aksidentale.
- Pas lidhjes së pajisjes elektroshtëpiake, ndizini të gjithë gatuesat për afërsisht tre minuta, për të kontrolluar operimin e tyre.

- Pajisjet elektroshtëpiake janë të përshtatshme për energji elektrike fotovoltaike, sipas kriterit që tensioni elektrik të jetë 220VAC - 240VAC me frekuenca gjysëm tonike 50Hz, në mënyrë që pajisja elektroshtëpiake të funksionojë në rregull (në mënyrë alternative mund të përdoret edhe një gjenerator me të njëjtat karakteristika teknike)."
- Lidhja e parregullt mund të shkatërrojë pjesë të pajisjes elektroshtëpiake, duke e bërë garancinë të pavlefshme.
- Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake, sigurohuni që tensioni i treguar në pllakën e të dhënave të jetë në përputhje me tensionin në qarkun e shtëpisë suaj. Tensioni i lidhjes (230 V drejt Neutrit) duhet të kontrollohet nga një teknik i kualifikuar, duke përdorur një pajisje matëse korresponduese!
- Kablli i lidhjes në pjesën e pasme të pajisjes elektroshtëpiake duhet të kalohet në mënyrë të tillë, që të mos takojë në murin e pasëm të pajisjes elektroshtëpiake, pasi kjo pjesë do të nxehet shumë gjatë operimit.



SHËNIM:


Urat lidhëse janë tashmë të instaluar në vendet e tyre përkatëse me kapëse. Vidhat në terminalet lidhëse janë të hapura, gjë që do të thotë se ato nuk duhet të lirohen ose të zhvidhosen më shumë. Kur të shtrëngohen vidhat, mund të dëgjoni një "klik" të lehtë, gjë që do të thotë se vidhat duhet të shtrëngohen / vidhosen deri në fund.

Për lidhjen mund të përdoret sa më poshtë:

- Kabëll lidhës prej gome i llojit H05 RR-F 4x1.5 me një përcjellës mbrojtës të verdhë dhe jeshil;
- Kabëll lidhës i izoluar me PVC i llojit H05 VV-F 4x1.5 me një përcjellës mbrojtës të verdhë dhe jeshil, ose kabëll tjetër i njëjtë ose më i mirë.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE


Paneli i të dhënave



- A Numri serial
- B Kodi
- C Modeli
- D Lloji
- E Marka tregtare
- F Informacioni teknik
- G Treguesit / simbolet e përputhshmërisë

NE REZERVOJMË TË DREJTËN PËR TË BËRË ÇDO
LLOJ NDRYSHIMESH TË CILAT NUK E CËNOJNË
FUNKSIONALITETIN E PAJISJES.

Udhëzimet për përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake mund të gjenden edhe në faqen tonë të internetit, në www.gorenje.com / < <http://www.gorenje.com> / >



Lined writing area consisting of approximately 40 horizontal lines.

www.gorenje.com

INFINITY

SVK65ES



sq (05-17)